




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U PRISHTINU/ MUNICIPAL
MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA



Nr.regj.37292/11

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Nadire Sahit Vitija, për kundërvajtje nga neni 7.parg.1 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen, dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, e në bazë të nenit 73.74.195, dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.23.12.2011 merrë këtë,

AKTVENDIM

E PANDEHURA: Nadire Sahit Vitija e lindur me 04.08.1965 në Prishtinë, ku edhe atni jetonë, Lagja e Spitalit, "Malush Kosova" p.n.e martuar, nënë e tre femijve, e gjendjes së mesme ekonomike, magjister me profesion, Drejtoresh Menaxhuese në Shoqatën e Ujësiellëve dhe Kanalizimit

Ë shtë përgjegjës

Sepse si Drejtoresh e Bordit në Ndermarrjen publike Termokosi-Ngohtorja e Qytetit në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit në afatin e caktuar ligjor, edhe pse ka qenë e njohtuar se është përfshirë në listën e Zyrtarve, të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë, me rastin e zgjedhjes së saj në funksionin udhëheqës. Me veprim të këtill ka kryer kundërvajtje nga neni 7 pika.1 lidhur me nenin 16 parg.1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë:

DENOHET

Me gjobë në të holla në shumë prej **500 (pesqind) Euro**, të cilën gjobë ka për ta paguar në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktvendimi merr formën e prerë. Në dobi të të hyrave gjyqësore të Kosovës, në Prishtinë në xhir. Rrjedh nr. 1000430070000518.

Nëse gjoben e shqiptur nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet në denim burgimi në kohëzgjatje prej 30 ditësh duke ju llogaritur 15 EURO në një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur. Në emer të paushallit gjyqësor e pandehura është i obliguar të paguaj shumën prej 5 EURO, në afat dhe xhirollogari të njëjtë me gjobën.

Pagesa e gjobes bëhet në të gjitha bankat e qytetit, kurse paushalli gjyqësorë në arkën e gjykatës. Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurit dhe parashtruesit të kërkesës.

Arsyetim

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë, me kërkesën nr.01-4111/11 të parashtruar gjykatës me datën 26.10.2011 për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit të permendur me lartë, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke vepruar sipas kërkesës, ka zhvilluar procedurën kundërvajtëse dhe në seance verbale ka ndegjuar të pandehurën e cili në mbrojtjen e vet deklaron: Është e vertet se nuk e kam bërë deklarimin e pasurisë nga se nuk kam qenë e njohtuar se jam e obliguar që ta bëjë këtë gjë, sepse mua nuk më ka lajmruar askush, e as zyrtari i lartë ligjor Nexhmedin Beha, të cilin e ka njohtuar AKP-ja për zyrtarët të cilët janë të obliguar ta deklarojnë pasurinë por i njëjti nuk na ka njohtuar. Unë e kam bërë deklarimin e pasurisë me dt.27.10.2011.

2.

Për sqarimin e kësaj qeshtje gjykatësi thirri në cilësinë e deshmitarit, **Nexhmedin Regjep Behen**, personin kontaktues, i cili në deklaratën e tij thotë: Bordin e Drejtorve e kam njohtuar mbi obligimin e tyre për deklarimin e pasurisë, njohtimin e kam bërë menjëherë mbas emrit të tyre, ku në atë mbledhje ka qenë edhe z. Nadire Vitija, drejtoresh në bord, Njohtimin e kam bërë në muajn korrik të vitit 2011, dhe të njëjtin ja u kam komunikue në gusht të vitit 2011.

Gjykatësi pas vlersimit të mbrojtjes së të pandehurës, deklaratës së deshmitarit, dhe provave të paraqitura nga institucioni përkatës, si dhe shkresave tjera të lëndës, erdhi në përfundim se e pandehura e ka kryer kundërvajtjen e cila e ngarkon, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të lartësisë së gjobës gjyqtari e pati parasysh peshën e kundërvajtjes, si dhe rrethanat tjera lehtësuese dhe renduese.

Duke i marrë parasysh të gjitha këto vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë gjobë mund të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit.

Me sa u tha më lartë u vendosën në dispozitiv të këtij aktvendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

VENDOSI GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.

Gjyqtari
Murat Paçarada

